

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm ,Divizioni Civil,** gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti , në çështjen juridike të paditësit M.H. nga fshati ..... Komuna Ferizaj të cilin e përfaqëson av.J.R. me autorizim, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm Ferizaj të cilën e përfaqëson përfaqësuesi Jetmir Ilazi, në çështjen juridike për anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës, në prezencën e paditësit, dhe të autorizuarit të tij dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.19.04.2016 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**NË BAZË TË POHIMIT**

**I APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit M.H. nga fshati ..... Komuna Ferizaj, e paraqitur kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm Ferizaj si e bazuar.

**II ANULOHET** – vendimi me nr.764 i dt.24.03.2015 i nxjerr nga Komisioni për Konstatimin e Përgjegjësisë Disiplinore pranë të paditurës si i paligjshëm.

**III DETYROHET** e paditura, që paditësin M.H. ta sistematizojë në punët dhe detyrat e punës, ku ka punuar para datës se largimit të tij, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet, ku përfshihet edhe kompensimi i të ardhurave personale deri në kthimin e tij në vendin e punës.

**IV DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia paguaj pagesën e të ardhurave personale në emër të dëmit të shkaktuar në shumën e përgjithshme prej 7.226.68€, (shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), për periudhën 01.04.2015 deri me dt.31.03.2016 me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë për një vite pa destinim të caktuar nga data e përpilimit të ekspertizës deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 756€, të gjitha në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

I autorizuari i paditësit në padi dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë duke theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se e paditura në kundërshtim me dispozitat ligjore ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit internist i caktuar në punët dhe detyrat e punës shef i Hemodializës, për faktin se

e paditura me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nuk i ka respektuar fare procedurat disiplinore e cila është vërtetuar me anë të pohimit edhe nga vetë e paditura me anë të përgjigjes në padi.

Andaj ka kërkuar nga ana e Gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditësit në tërësi si e bazuar duke propozuar gjykatës që të merr aktgjykim në bazë të pohimit.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës në seancën e datës 19.04.2016, ka munguar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flet kthesa e Gjykatës ku ftesën e ka pranuar me datë 08.04.2016, shtyrjen nuk e ka kërkuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj Gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurës konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

E paditura me anë të përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar kërkesë padinë e paditësit, edhe pse për gjykatën e njëjta është e mangët me që konsideron se ka një mospërputhje në mes faqes një dhe tre por petituimi i saj është i qart me të cilin edhe i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Nuk është deklaruar për shpenzimet e procedurës

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjate shqyrtimit kryesor ka bere administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave. U lexua padia e paditësit C.nr.275/15 e dt.12.05.2015, vendimi i të paditurës nr.841/15 i dt.16.04.2015, autorizimi i paditësit dhënë av.J.R., përgjigja në padi e dt.01.02.2016 në dy faqe (faqe 1 fleta dy dhe faqe tre fleta tre), kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës e dt.01.12.2010, vendimi nr.protokolli 764 i dt.24.03.2015, vendimi nr.protokolli 766 i dt.25.03.2015, vendimi me nr.345 i dt.29.10.2014, ekspertiza e ekspertit financiar E.P. e dt.17.02.2016.

Meqenëse e paditura në përgjigje në padi e ka pranuar kërkesë padinë e paditësit, gjykata nuk u lëshua në administrimin veq e veq të provave pavarësisht se ka bërë nxjerrjen e tyre dhe në rastin konkretë ka marr aktgjykim në bazë të pohimi në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së, me që palët ndërgjygjëse mund të disponojnë lirisht me kërkesëat juridiko-civile, sipas nenit 3.1 të LPK-së të cilat kërkesa nuk kanë qenë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit në kuptim të nenit 3.3 të LPK-së.

Gjykata e ka marr këtë aktgjykim pasi që e paditura në bazë të nenit 148.4 të LPK-së deri në nxjerrjen e këtij aktgjykimi deklaratën mbi pohimin e kërkesë padisë së

paditësit nuk e ka revokuar verbalisht në seancë gjyqësore, apo me anë të parashtrës jashtë seancës gjyqësore.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj e paditura obligohet të paguaj shumën e përgjithshme prej 756€ dhe atë 101€ për përpilim të padisë, për tri përfaqësime në seanca nga 135€ shumën e tërësishme prej 405€, për ekspertizë financiare shumën prej 150€, për taksë gjyqësore për padi shumën prej 50€, si dhe për përpilim të aktgjykimit shumën prej 50€.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**C.nr.275/15 më dt.19.04.2016**

**Gjyqtari**  
**Alban Beqiri**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinës, përmes kësaj gjykate